

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika Boom<sup>®</sup>-520 Low Expansion

SHKUMË PUR ME 1 PËRBËRËS DHE ME ZGJERIM TË ULËT QË APLIKOHET ME PISTOLETË PËR MONTIME DHE NGJITJE.

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika Boom<sup>®</sup>-520 Low Expansion është shkumë poliuretani me zgjerim të ulët për montim dhe ngjitje. Rezistencë e mirë ndaj vibrimeve. Kthehet në formën e saj origjinale pas ngjeshjes.

### PËRDORIMET

Sika Boom<sup>®</sup>-520 Low Expansion përdoret për montime, fiksime, izolime dhe ngjitje të shkallëve prej druri, pervazeve të dritareve, mbushje të fugave të lidhjes përreth kasave të dverve dhe dritareve, përreth hapjeve të tubave të kondicionimit, grilave me rula, etj. Përdoret për izolim kundër tingujve dhe të ftohtit, etj.

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Aplikim i lehtë me Sika<sup>®</sup> dispenser gun
- Dozim i lehtë dhe i saktë – konsumimi ulët
- Posaçërisht i përshtatshëm për fugat e ngushta
- Ruan elasticitetin
- Tharje e shpejtë
- Zgjerim shumë i ulët
- Ngjitet mbi të gjitha materialet e ndërtimit, si druri, aerobeton, metali, alumini, tullat
- Izolim i shkëlqyer i temperaturës
- Amortizim akustik efikas
- Pa CFC / HFC
- Nuk ngjitet mbi PTFE, PE dhe silikon.

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Baza kimike</b>	Poliuretan me 1 përbërës, thahet me lagështinë	
<b>Ambalazhi</b>	kanaçe 750 ml, 850 g (12 copë/ kuti)	
<b>Ngjyra</b>	E verdhë e lehtë	
<b>Jetëgjatësia</b>	12 muaj nga data e prodhimit nëse zbatohen kushtet e magazinimit.	
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Të ruhet në ambalazhin origjinal dhe të padëmtuar, në kushte të thata dhe i mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor dhe në temperatura midis +5°C dhe +25°C. Kanaçja duhet të ruhet në pozicion vertikal!	
<b>Dendësia</b>	20 kg/m <sup>3</sup> (± 3 kg/m <sup>3</sup> )	
<b>Rezistenca ndaj ngjeshjes</b>	~ 0.03 N/mm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 421)
<b>Rezistenca ndaj tërheqjes</b>	~ 0.14 N/mm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 455)
<b>Zgjatimi deri në thyerje</b>	~ 27% (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 455)
<b>Rezistenca ndaj prerjes</b>	~ 0.07 N/mm <sup>2</sup> (në 23°C / 50% lagështi relative)	(DIN 53 427)
<b>Qëndrueshmëria e përmasave</b>	~ ± 1% (në 23°C / 50% lagështi relative)	

<b>Reagimi ndaj zjarrit</b>	B3, DIN 4102, Pjesa 1
<b>Përthithja e ujit</b>	< 1% vëllimi (cut surface)
<b>Temperatura e funksionimit</b>	-40°C deri në +80°C
<b>Konsumimi</b>	Konsumimi mund të rregullohet duke adaptuar presionin e valvulës të Sika® Dispenser gun. Rendimenti: 1 kanaçe 750 ml deri në 43 l (± 3 l) shkumë.
<b>Temperatura e mjedisit</b>	+5°C min. / +30°C max.
<b>Temperatura e nënshtresës</b>	+5°C min. / +30°C max.
<b>Koha e maturimit</b>	Një pikë 20 mm shkumë të zgjeruar mund të pritët pas 20-45 minutash (në 23°C / 50% lagështi relative). Tharje e plotë pas 24 orësh (në 23°C / 50% lagështi relative).
<b>Koha e tharjes së sipërfaqes</b>	~ 7±2 minuta (në 23°C / 50% lagështi relative)

## UDHËZIME APLIKIMI

Temperatura e kanaçes duhet të jetë +5°C min. dhe +30°C max. Për rrjedhje dhe zgjerim të duhur temperatura e kanaçes aerosol duhet të jetë ~ +20°C. Mbroni kanaçen nga dielli dhe temperaturat mbi +50°C (rrezik shpërthimi).

Për tharjen e saktë të shkumës nevojitet lagështi e mjaftueshme.

Të mos përdoret mbi PE, PP, Teflon, silikon, vaj, graso apo disarmentë të tjerë.

Shkuma nuk ka rezistencë ndaj dritës UV.

Lexoni rekomandimet teknike dhe për sigurinë të printuara mbi kanaçen.

## PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e thatë dhe e pastër, homogjene, pa vaj dhe graso, pluhur dhe grimca të lira ose të shpërbëra.

Nënshtresat poroze duhet të lagen paprapakisht me ujë të pastër, kjo siguron ngjitje më të mirë dhe tharjen e duhur të shkumës.

## METODA E APLIKIMIT / MJETET

Tundeni mirë kanaçen përpara përdorimit (~ 20 herë). Hiqni kapakun e vogël të zi nga kanaçja e Sika Boom®-520 Low Expansion. Mbërtheni kanaçen tek Sika Boom®-G Dispenser. Shtypni lehtë këmbëzën e Sika Boom®-G Dispenser për të aplikuar shkumën. Shkuma duhet të jetë në temperaturë dhome, nëse është më e ftohtë, vendosni ambalazhin në ujë të ngrohtë (max. T = 40°C) për rreth 20 min. Aty ku duhet të mbushen hapësira të vogla, përdorni tubin e zgjatimit me produktin (rrjedhja e shkumës është më e pakët me tubin e zgjatimit). Kujdesuni që secila shtresë është tharë mjaftueshëm. Të gjitha fiksime dhe elementet, etj. duhet të mbështeten përkohësisht derisa shkuma të jetë ngurtësuar. Mos e hiqni kanaçen e Sika Boom®-520 Low Expansion nga Sika Boom®-G Dispenser nëse nuk është e nevojshme. Nëse kanaçja do të hiqet nga Sika Boom®-G Dispenser, pa e pastruar me Sika Boom® Cleaner, mund të çojë në tharje të parakoshme dhe mosfunksionim të Sika Boom®-G Dispenser. Mënyra më e sigurt është të mbahet kanaçja e montuar tek Sika Boom®-G Dispenser derisa të zbrazet.

## MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni menjëherë pikat e freskëta me shkumë duke përdorur Sika Boom® Cleaner / Sika® Remover-208. Materiali i tharë mund të hiqet vetëm mekanikisht.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdoqë afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdoqë forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika Boom®-520 Low Expansion  
Maj 2019, Botimi 01.01  
02051406000000095

SikaBoom-520LowExpansion-sq-AL-(05-2019)-1-1.pdf